

8JH-1  
G.15

SHIETI

GJIROKASTËR

*Bajazit  
Cahani*

**RRJEDH  
NJË  
LUMË...**

*poezi*

1148  
—  
CIS

REGJESTRUE  
INDOG. QELLA

**BAJAZIT  
CAHANI**

**RRJEDH  
NJË  
LUMË...**

11665

**Poezi**



---

SHTËPIA BOTUËSE  
«NAIM FRASHËRI»

## **URA E MADHE**

Mbi Drinin e Bardhë madhërishëm është ngritur  
një urë  
me themele dhe kolona prej ferrobetoni.  
Djersa e Hasit dhe Lumës nëpër trupin e saj është  
bërë gurë,  
që kurrë më  
mos të ndahan nga lumi si qëmoti...

Edhe atëherë pati duar burrash,  
që brigjeve të këtij lumi ngriten harqe urash,  
po të tjerë me emra vezirësh e bajraktarësh me  
baromina vinin  
dhe harqet njerëzore të urave rrëmihnin...

Në brigjet e lumit Drin  
ngriheshin istikamet:  
«Ju jeni Hasi,  
ne lumianët...»

Dhe pastaj brigjeve sodiste Jagoja i tragjedisë  
lojën e përgjaktë fatzezë të hasmërisë...

Shumë brigje kemi lidhur nëpër Shqipëri,  
shumë ura kemi ndërtuar këtyre vjetëve,  
po më të madhen e të gjitha kohërave e ndërtovë  
ti, Parti,  
urën midis njerëzve!...

## *RRJEDH NJË LUMË...*

Rrjedh një lumë në tokën time  
një lumë me ujë të kulluar bjeshkësh ngjyrë qielli  
të thellë...

Me rrjedhje të pashuar është ky lumë.

Kullon nëpër katarakte të kohës

e në çdo katarakt montojen llampa.

I qetë dhe i rrëmbyer është ky lumë.

Në qetësinë e tij pasqyrohen në lëvizje

ëndrra bjeshkësh,

ëndrra fushash,

ëndrra qytetesh të ardhshëm...

Rrjedh qetë.

Rrjedh,

rrjedh,

vérshon,

lan ky lumë me rrjedhje të pashuar

e jetën ngallon brigjeve.

## NJË KUJTIM FEMINIE

Në çatinë e gurtë të maleve  
fëmi — po luaja,  
duke ndjekur fluturat krahëbardha që farfurinin  
nëpër rrezet e diellit.

I harruar pas lodrave të mia këmbëzbathur,  
duke luajtur me fluturat e bardha e rrezet e diellit,  
më gjeti një njeri.

Më pa, më pa thellë në sy...  
— Bukur, — tha dhe qeshi.  
Më pa këmbët e zbathura  
e një palë këpucë të reja më veshi.  
E në duart e mia të vogla,  
një laps e një fletore më la dhe fytyrëqeshur iku...  
duke lënë në fundin e fletores shënimin.

Partizani

E ku s'e kërkova,  
po kudo që shtegtova, për ta takuar atë njeri,  
gjithkund, me fytyrën e tij të qeshur,  
të gjeta ty, Parti!

## **LIKENI I KUQ<sup>1</sup>**

Një natë me hënë erdhën romakët,  
një natë me hënë...

Po hëna-shkretëtirë gojë kurrë nuk pati dhe  
asnijëherë nuk tha asnijë fjalë,  
veç brigjet e Arbërisë spërkatit me dritën e saj të  
brymtë...

Një natë me hënë.  
u shfaqën romakët me ngjyrën e hirtë të vdekjes  
në dheun e lashtë të arbërit.

Një natë me hënë dhe yje të shuar ata erdhën,  
po para se të ngulnin heshtat dhe frazat latine të  
padrove  
në zemrën e fushave,

në kurrizin e maleve,  
brigjeve a rrafshultë,  
u ndeshën edhe me djemt e çikat e Hasit  
dhe u krijua kështu Likeni i Kuq...

---

1 Like i Kuq (Liqeni i Kuq) quhet një fshat në pllajën e Hasit, i ndërtuar sot thuajse krejt i ri, për të cilin flet edhe një legjendë e hershme.

Tokë e shtrenjtë!  
Edhe kur të mungoi shkrimi dhe letra,  
për të shkruar dhimbjen,  
   historinë,  
mijëvjeçarëve pasardhës  
(që kurrë të mos harrojnë)  
me gjuhën e emrave monument prej gjaku,  
   u fole mbi tragjedinë...

Like i Kuq, Like i Kuq!  
Gojë e hapur më gjak të mpiksur...  
Gojë e ngurosur prej gjaku...

Like i Kuq, Like i Kuq!  
Trëndafil i bardhë i ditëve tonë,  
   me rrënjet në gjak...

## ***NUK DONIM TË QANIM...***

*Bashkëluftëtarit të Bajram Currit.*

Po mbushje shekullin dalngadalë.  
Edhe pak... edhe pak nuk duhej të vdisje, Bacë!  
Gjithë jetën më fole për Isën, Azemin, Shotën e  
Hasanin,  
për Bacën Bajram, Riza Cerovën e Ali Kelmendin,  
se njojur ishe me ta në rrugën e mundimshme të  
kombit.

Në përvjetorët e tyre bije në mendime  
dhe thoshje pastaj:  
«Mortë mos paç kurrë, moj Partia trime!»  
Dhe thoshje pastaj:  
«Bijtë e mi,  
kudo që të jeni,  
mos pushoni së luftuari për fjalën e saj.  
Gjer këtu e prumë, thuajse, vetëm, gjithmonë,  
Shqipnjinë,  
mos pushoni së luftuari, bijtë e mi.  
Ne lirinë, bukën, diturinë kërkonim,  
Enver Hoxha me Partinë po bëjnë më shumë  
se sa ç'dinim ne të ëndërronim...»  
Edhe pak... edhe pak nuk duhej të vdisje, Bacë!  
Edhe pse pe Shqipërinë si një tufë dritash,

1

duke llamburitur këtu në brigjet e Ballkanit,  
edhe pse pe traktorin e parë shqiptar mbi këtë tokë  
të lashtë të lërojë,  
i lumturi Bacë, ti nuk duhej të vdisje,  
se ne nuk donim vetëm ti të na shihje,  
por edhe ne të të shihnim....

Ti nuk duhej të vdisje, Bacë, edhe ndonjë ditë...  
Ditën e Flamurit mbolle sytë,  
se shumë luftove për të me bashkëkohësit e tu,  
nëpër mote mushkëritë t'u dogjën duke thirrur:  
«Liri! Liri!»

Ti me 28 Nëntor mbolle sytë,  
që flamurin kur të kujtojmë, të kujtojmë edhe ty,  
o' Baca ynë i dhembshur.

Të gjithë erdhën në varrimin tënd;  
njerëzit heshtnin... të donin... nuk donin të të  
qanin...

Mbi varrin tënd  
29 Nëntori shkundte drita... qetësi... qetësi...

Nuk donim të të qanim...  
Vetëm qelli mbi dheun e butë rigonte shi... shi...

## V L O R E

Vlorë!

Qytet i lagur, në lëvizjen e përjetshme të detit,  
lulëzuar me gjakun e martirëve, të mpiksur poshtë  
agrumeve...

Në këto ditë të bukura lirie,  
sa herë zbres te ti,  
nga bjeshkët veriore të sjell një lule bozhurë  
(rritur buzë një honi)

e ti,  
si udhëtarin e largët e mikun verior,  
buzëmbrëmjes më freskon me lëng limoni...

Qytet i dashur,  
me ngjyrën e dallgëzuar të detit në sy...

## **UNË DHE DRINI**

Unë

dhe

Drini

bri njëri-tjetrit të shtrirë

dukemi

se flemë.

Vetëm shtretërit pranë e pranë i kemi.

Ditën dhe natën rrjedhim, rrjedhim...

Në thellësitë e tij

dridhen yjet e mjegulluar.

Dhe tek unë

dridhen e dridhen

yjet e ndritshëm,

Në hapësirën blu ngrihen yje të rinj...

E, mes meje e Drinit,

një këngë që rrjedh e rrjedh...

## **MALET SHQIPTARE**

**Malet shqiptare  
nga gjallim i jetës  
përherë gjelbëruar...**

**Trak e truk,  
trak e truk...  
Mbi to  
sa herë ka dashur të ngjitej Kali i Trojës,  
me barkun e madh,  
për të kullotur e  
rrënuar...**

## **Malet shqiptare**

**trak e truk  
trak e truk...  
trokëllimë patkonjsh,  
që nga lashtësia.  
Grrap e grrup  
grrap e grrup...  
përtypje e eshtrave të kuajve  
gjer në ditët e mia.**

**Malet shqiptare  
fundosje e varrit të perëndive...**

Unë biri i tyre në këtë shekull  
bashkë me dashurinë time,  
u thërras gjithë dashurive të këtij shekulli:  
poshtë këmbëve të mia  
janë varret e perëndive  
e unë  
jam zot mbi zotat  
me forcën e Partisë sime!

**Malet shqiptare,  
varri i perëndive,  
ku thyejnë këmbët gjithë mëzat e kuajve të  
Trojës.**

**Malet shqiptare  
simbol qëndrese,  
çerdhe e dashurive të ndershme,  
buzë Adriatikut,  
farfurim dritash lirie!...**

## **NË FUSHËN E STËRVITJES**

Mbi supe avuj shiu dhe djerse,  
si ylbere ngrihen nën rrezet e diellit.

Nën pëllëmbët tona  
toka e lashtë e Atdheut  
me zëra shekullor ilirësh...

Mbi supet tanë  
lavdia e hershme dhe krenaria e re,  
Atdheu.

Forcoje krahun shok!  
Pesha është e rëndë,  
detyra edhe më e rëndë,

për këtë tokë socialiste  
me lulëzim të përhershëm...

## *DUKE PARË KOSTARET*

Kështu ka vringëlluar nëpër mugëtirën e shekujve  
kosa e fisit tim.

Në teh të saj varfëria,  
në teh të saj thinjej dashuria,  
në teh të saj pikonte gjaku i hasmit të vrarë,  
në teh të saj lotët e motrës për vëllanë,  
se nuk të linin të jetoje në hallin tënd, fisi im,  
ndaj kosa jote si barin e bjeshkës i ka prerë me  
tërbim!

Kosa e fisit tim...

Ke prerë dhe veten,  
me dashurinë tënde ka përgjakur dhe pranverën...

Unë e di, fisi im, e di,  
ish koha që t'ka shtyrë.  
Të shtynte beu, bajraktari,  
të shtynte Kanuni i Lekës  
dhe ti nuk kishe çfarë t'u bëje  
e ktheheshe i bije me kosë vetes...

Pastaj...

Pastaj bëje këngë,  
këngë,

sa tresje edhe gurin për dashurinë  
o shpirt i madh,  
që me kosë në dorë kërkoje lirinë!

11665

## P I K E L L I M E<sup>1</sup>

Ndanë udhëkryqit të shekujve  
u mpive —  
                    piramidë e akullt me fytyrë të trishtë.  
Kah bota, njerëzit,  
                    me vështrim të pikëlluar.

C'kratere të tmerrshme vullkanike të ngurosën  
                    ndanë udhës,  
ç'erë vjeshtake zemrash  
                    të zverdhi në shpirt?!

Ti ndër kohëra  
nga sytë e gurtë pikove vetëm:  
                    pikëllim, pikëllim...

---

1 Mal në lindje të qytetit të Kukësit.

Pikëllimë —

mal i ngurosur  
i dhembjes së popullit tim ndër shekuj...

Pikëllimë —

psherëtimë e së kaluarës,  
në ty sot jetë —  
                        mal i gëzimit tonë!...

## *SA HERE...*

Sa herë mpleks gishtat nëpër dheun e kësaj toke,  
për të mbjellur farë gruri,  
në çdo kokrrizë dheu  
shoh gjurmët e gjakut të të rënëve.

Sa herë ngre pallate qytetesh të rinj,  
nëpër dheun e tullës që vë në mur  
lulojnë zëra: «Kujdes tullën,  
kur ta vini në mur, kujdes.  
Muret e shtrembëra shemben  
e ne  
pastaj eshtrat na dhembin...»

Atëherë në lartësi kalash, oxhakësh dhe fasadash  
kujtimi i tyre në pranverë  
na kuqlon këmishën e bardhë...

Çdo kokrrizë dheu e kësaj toke  
na kujton zërin e përgjakur të të rënëve.

Në pikat e djersës që na pikojnë  
ëndrrat e të rënëve lulojnë  
sa herë...

## **KUR HYJ NË QYTETIN E DËSHMORËVE...**

Në Qytetin e Dëshmorëve  
herë pas here shkoj me fëmijët e mi përdore.

Kur hyj,  
fëmijët me doçkat e vogla përkëdhelin emrat e  
tyre në pllakat e bardha,  
nga pllakat mua më përftohen zëra...  
e harrohem në heshtjen e gjatë zërat duke i  
dëgjuar,  
vetëm kur fëmijët më prekin lehtë krahun,  
zgjohem...  
më ngjan pastaj sikur ecim bashkë nëpër rrugën  
e asfaltuar...

## **TOKAT E MBJELLURA**

Qielli i sfungjertë shkund shi mbi tokat e mbjellura,  
toka ka hapur gjoksin, ka çliruar gjymtyrët  
dhe thith e thith shinë e butë,  
bima shpërthen gjirin e tokës  
e zgjatet për të sosur shiun gjer në qiel.  
Toka kënaqet nën shi,  
bima shuan etjen nën shi,  
bima rritet si foshnje nën shi,  
qielli hedh ujemin e stinës...

## G J E R È S I

Në hapësirën e përthyer të këtyre maleve  
harlisenëndrrat —

degëza të njoma.

Si misri nën vadë

gudulisen nga rritja,  
luajnë, si fëmija

e mëkohen me hapësirën e blertë të këtyre ditëve,  
që sythojnë ndrra

e për çdo ndërr

djersët pikojnë,

pikojnë.

Unë në kraharorin tim ndiekam

ofshamën e vlagshme dhe gjerësinë e këtyre  
maleve.

## **NË KËMBËT E URAVE**

Drini i Zi  
me shkumëzime valësh gremiset grykave.  
Në qytetin tim të vjetër  
sjell ngjyrën e kuqërrëmtë dibrane.  
I Bardhi —  
ngjyrën gri argjilore të Rrafshit.  
Të dy rrabin brinjët e qytetit tim,  
herë të qetë  
herë me rrëmbim.  
Të dy vijnë e derdhen në një shtrat,  
të dy zgjaten si tela çiftelie  
e së bashku këndojnë ëndrrën shqiptare të lashtë,  
rapsodinë e dritave...  
E,  
bashkëqytetarët e mi,  
nën tingujt e kësaj uverture rapsodike,  
si në themelet e një kështjelle,  
murosin Rozafën e Djersës në këmbët e urave.<sup>1</sup>

**1974**

---

<sup>1</sup> Urat e mëdha që lidhin brigjet e Drinave dhe rrugët për në qytetin e ri të Kukësit

## *QYTETI I RI*

I ndërtuar me elementë të njojur:  
me tulla,  
përbërë prej dheut si gjithë tullat e botës,  
me dërrasa, parkete,  
përbërë prej druri si gjithë parketet e botës,  
me soleta,  
përbërë prej betoni të gurtë si gjithë betonet e  
botës,  
me ndërtesa të thjeshta  
pa stilizime të moderuara arkitekturore,  
me rrugë të gjera prej asfalti dhe guri,  
ku fryjnë gjithnjë erëra.

Prapë ky s'do të mbante për ne epitetin «i ri»,  
po të mos e mbante që në themelë vulën e  
socializmit.

Ky s'do të mbante për ne epitetin «i ri»,  
po të mos kishte për banor njeriun e socializmit.

Ky është qyteti im i ri  
më i riu se gjithë qytetet e botës,  
që është ndërtuar nga duart tona të ndershme  
me pikë djerse...  
Që mbrohet nga zemrat tona  
me pikë gjaku...

## **NUK HARROJME...**

Nuk harrojmë...

Qyteti im,  
ende bie erë baroti.  
Atë e ndiejmë më fort, kur ulemi pranë veteranëve.

Nuk harrojmë...

Toka ime,  
ende nuk i ka mbyllur plagët e luftës.  
Atë e shohim gjatë hapjes së themelive dhe tokave  
të reja.

Nuk harrojmë...

Dashuria,  
ende ndien në kraharorin e bardhë dhimbje.  
Atë e dëgjojmë te gratë dhe motrat tonë  
mbrëmjeve.

Nuk harrojmë...

Fëmijët tanë,  
nuk do të marrin plagë si tonat.

Atë e shohim në sytë e kristaltë  
të fëminisë së jetës që po rritet.

Nuk harrojmë...

Po ne e dimë,  
lufta jonë vazhdon...  
Edhe fëmijët tanë këtë e dinë,  
përderisa në botë ka të shtypur dhe tiranë!

Nuk harrojmë...

## *D J E P I*

Ja djepi im,  
prej druri të rritur në tokën e Hasit,  
ndërtuar nga duart e bacës tim të vyer.

Djepi im,  
i qullur nga qumështi dhe lotët e nënës:  
    «nina-nana, bir,  
    m'u rritsh për të mirë!»

Djepi im,  
i shpëtuar nga flakët e luftërave  
nëpër hije lisash e shpellash,  
nëpër hije murrizash e shullaneve  
ruajtur nga zemra e nënës:  
    «nina-nana, bir,  
    këndofsh për të mirë!»

Djepi im,  
përkundja e shpresave të së ardhmes  
me këngën në buzë të nënës:

«nina-nana, bir,  
m'u rritsh pér të mirë,  
nina-nana, bir,  
këndofsh pér të mirë!»

Djepi im,  
belbëzimet e mia,  
klithmat e mia,  
shpresat e nënës,  
ëndrrat e nënës.

Djepi im,  
përkundja nëpër kohë e këngëve të mia:  
«nina-nana, bir  
thuaje këngën e lirë!»

## **DUKE KËRKUAR KËNGËN PËR POPULLIN**

E kërkoj këtë këngë nëpër këngët e hershme dhe  
të reja,  
e kërkoj këtë këngë nëpër shtigje e rrugë, ku ka  
gjëmuar historia,  
e kërkoj këtë këngë lart në male, ku bora është e  
thinjur,  
e kërkoj këtë këngë thellë në fundin e shpellave,  
në fundin e legjendave,  
në lotët e elegjive,  
në qumështin e dashurive,  
nëpër 'flakën dhe tymin e trimërive.

E kërkoj këtë këngë në thellësinë e shpirtit tënd,  
**populli im!**

Dhe e kuptoj, unë biri yt,  
se duke kërkuar këngën për ty, thellë vetes sime,  
të kërkokam të terin ty,  
me brengat, gjëzimet,  
me optimizmin, shqetësimet,  
me vdekjet dhe lindjet,

veten duke lënë pas këngës për ty, populli im!

*HOJ, DADA, HOJ...*

*Motiv i motshëm*

Kjo pranvera zemrat na i ka brejt,  
po vjen vjeshta e na merr krejt,  
hoj, dada, hoj...

Në pranverë zemrën ia dhash tjetër kuj,  
po kjo vjeshta po na çon në derë të huaj,  
hoj, dada, hoj...

Në m'paç dasht, djalo, dil e më merr,  
mos më le të shkoj në tjetër derë,  
hoj, dada, hoj....

Për ty dada jam rritur si molla në degë  
e veç rrezja e diellit më ka prek,  
hoj, dadaj, hoj...

Veç rrezja e diellit më ka kuqlue  
e rrezja e hënës më ka freskue,  
hoj, dada, hoj...  
hoj, dada, hoj...

M'është çarë zemra si kokrra e shegës,  
tue të prit dada në maje të bjeshkës,  
hoj, dada, hoj...

Dritën e hënës do të vë në vend të velos,  
po më dole, dadë, djalë i besës,  
hoj, dada, hoj...

Po më dole, djalo, trim i besës,  
po më more, djalo, para të dielës,  
hoj, dada, hoj...

Kjo prenvera zemrat na i ka brejt,  
hoj, dada, hoj,  
hoj, dada, hoj...

Po vjen vjeshta e na merr krejt,  
hoj, dada, hoj!....  
hoj, dada, hoj!....

## **NGA KU NISIN UDHËN DITËT...**

Peshë e rëndë lakon kurrizin e malit të

Koritnikut —

jeta dhe energjia punëtore!

Çdo gjë

ajo ndryshon,

pareshtur transformon çdo gjë.

Ku prekin duart e saj

çdo gjë merr trajtën e re.

Minatorët me rrobat e punës kanë ngjyrën e malit  
dhe mali nga zëri i tyre lëshon tinguj këmbane.

Jeta

në sytë e tyre shkruan qindra poezi e romane,

jeta,

e imja,

e jotja dashuri

dhe e jotja, vogëlushja ime Mirelë.

Nga duart e tyre degëzon,

harliset,

jeta,

si trëndafili në maj çel..

Punëtorët,

ja, se si e peshojnë dhe e rrotullojnë nëpër duar  
jetën...  
si gurët e çmuar të mineralit.

Peshë e rëndë lakon kurrizin e mineraltë të  
Koritnikut —  
punëtorët,  
ëndrrat  
dhe sekondat heroike!

Ja, punëtorët...  
Çdo gjë ata krijojnë,  
themelet e botës mbajnë.

Punëtorët  
jetën nëpër duar rrotullojnë.  
Pesëvjeçarët e socializmit  
nga njëri kat në tjetrin  
i ngrenë.

Dashuria ime,  
(e sheh?)  
edhe diellin duket sikur me baromina e ulin në  
perëndim  
dhe prapë e nxjerrin në lindje...  
punëtorët,  
nga ku nisin udhën prapë  
ditët!

## **KUR PREK POPULLI TELAT E SHARKISE**

Kur prek populli telat e sharkisë,  
bën të heshtin  
edhe zogjtë në degë  
edhe erën në bjeshkë.

Nga telat e saj,  
si nga qelli pa anë,  
shkundet shiu i këngëve të tij!

Kur prek populli telat e sharkisë,  
unë, poeti,  
foshnje u bëkam me këngën time  
dhe s'u ngopkam duke pirë gjë  
te nëna e poezisë!...

## **QYTEZAT VERIORE**

Zbardhin brigjeve të Drinit fshatrat e reja  
si pulëbardha gati në fluturim...

Tufë-tufë shfaqet nga bregu në breg  
gazi i jetës    nën hapësirë të kaltër qielli.  
Qytezat veriore    me dritare nga dielli...

## **POEZIA E NJË NATE**

Natën,

kur po shkruaja poezi në orën 12-të,  
nga tavolina e shkrimit u ngrita qetë-qetë.  
Dola jashtë dhomës. Jashtë.

Qetësi... Qetësi...

Llambat neon të qytetit verior varur nëpër shtylla  
digjeshin rrugëve.

Në heshtjen e tyre  
shkarkohej vazhdimisht energji.

Dola jashtë qytetit. Jashtë.

Qetësi... Qetësi...

Sa bukur! Të qetë, të lumtur çlodhen  
bashkëqytetarët e mi.

Tutje periferisë,  
buzë Grykës së Vanës,

metalurgët  
nëpër furrat e shkrirjes  
digjinin dhe digjinin qetësinë e natës.

Rropamë bunkerësh,  
lëvizje krahësh, levash.  
Mbi ballin e metalurgëve,  
si mbi ballin e qiellit yjet,  
rrokulliseshin pikat e djersës.  
Llava e metaltë ngjyrë dielli rrjedh.  
Në lëkurën e natës,  
pa pushuar,  
shkruan me gëрма të zjarrrta  
kapituj të historisë së klasës!

Ja kënga e kundërrethimit, e kundërblokadës,  
shok,  
me grykën e ajrorit atje tutje që vështron në  
horizont!...

Dhe nxora nga xhepi  
një cikël vjershash tellalle,  
në furrën e shkrirjes i hodha me neveri,  
si të ishin fatthëna të përrallave.  
Metalurgët ngriten kasketën dhe qeshën.

Nga e qeshura e tyre  
gjëmuani aggregatët,  
uzina gjëmonte dhe qielli,  
bakri i shkrirë rridhte  
dhe nëpër kallëpe binte,  
si copëra dielli.

Dhe bashkë me metalurgët e çelëm mëngjesin...  
Shpirti i tyre kish shkëlqim më tepër sesa dielli  
në horizont  
dhe ditën e re e mbartëm mbi supet tona edhe  
në tjeter front!...

## UNE ME NXËNËSIT E MI

Unë me nxënësit e mi  
sot mbledhim kallnj gruri  
me ngjyrën e artë të korrikut verior.

Duaj-duaj i bëjmë  
dhe i bashkojmë në lëmin tonë të përbashkët.

Qëmtojnë fije-fije kallnj gruri nëpër hamullorë,  
si në botën e gjerë qëmtohet dashuri e dli  
nxënësit e mi,  
dhe tufën e kallnjve  
herë-herë e lëkundin lart në hapësirë  
nga kjo tokë lirie,  
sikur botën proletare duan të përshëndesin,  
sikur botës proletare në ballë  
t'i vënë duan  
këto tufa të kallnjve!

## *PO SI U GDHITË, MORE SHOKË?*

Po si u gdhitë, more shokë?  
Të dridhurat e nëntokës  
tërë natën e natës  
erdhën gjer te tavolina ime e shkrimit.  
Nën pëllëmbët tuaja  
tërshtitej

dheu,  
minerali.

Në tavolinën time  
tërshteshin,  
si minuta sterile  
copérat e gjumit  
dhe mbi fushën e bardhë të letrës,  
si mbi bunkerët dhe vagonat tuaj,  
ranë mendimet për ju gjer në mëngjes.

Mbrëmë  
tërë natën e natës  
ra borë me skllotë.  
Po si u gdhitë, more shokë?

## NË SUP TË BJESHKËS VOGËLUSHJA LULË

Dashuria për njerëzit  
gjithnjë m'i shtrin shtigjet drejt banesës së  
malësorëve.

Nëpër të gjitha stinët  
mëngjeseve dhe mbrëmjeve  
çelen dyert e tyre për mysafirët e dashur.

Ja dhe kjo mbrëmje e vonë.  
Në bjeshkën alpine  
vjeshtë e vonë.

Po ti vogëlushe  
ç'më dole këtu papritur në këtë dhomë miqsh  
në kullë  
e ulesh pranë meje,  
si pejzash i bukur pranvere nën këtë qìell dhoma  
me sytë e bukur qìelli,  
me emrin e brishtë Lulë.

Unë të pyes për babanë,  
ti dorën e vogël e ngren drejt llambës së ndezur  
si luledrite në tavan

dhe e kuptoj vogëlushe.  
se ai punoka diku në Fierzë apo Koman.

Vjeshtë e vonë. Në bjeshkë mjegull, acar,  
vogëlushja Lulë,  
ç'm'i mbështolle ëndrrat gjithë natën  
me një pranverë të paparë!

Mëngjesi i së nesërmes  
prapë më shtegtoi në udhë,  
po nga mendja s'do më hiqet asnjëherë:

në supin e bjeshkës  
vogëlushja Lulë...

## **NË MËNGJESET QË PO LINDIN...**

*Gani Durakut*

Toka e përgjakur rrotullohej kah lindja  
e agu i mëngjesit  
po i grahët natës drejt perëndimit...  
Ti re në Kodrën e kuqluar me fytyrë kah zgjohej  
mëngjesi, mëngjesi i 17 nëntorit të 44-s.  
Ne nuk kishim me se të të mbështillnim, Gani,  
të mbuluam me dritën e mëngjesit,  
që po lindte,  
dhe plumbat i hodhëm breshëri,  
andej kah sulmoje ti.  
Mbi dheun e butë të varrit tënd në kodrën e  
kuqluar, atë ditë,  
gjithë ditën e ditës rigoi shi.  
Shi.  
Mbi tokën nënë,  
që atëherë,

nisi mungullimi i ëndrrave të tua.  
Në mëngjeset që po lindin, Gani,  
shohim edhe ftyrën tënde  
me dhimbjen e lindjes...  
Mbi supe hedhur kaparanën e leshtë  
që ta rreh era në fluturim,  
                                si krahët e shqipes...

## **KULLAT E DHIMBJES**

Nën strehë shkëmbinjsh,  
buzë rrëpirave,  
vareshin hallet e popullit tim me kullat e  
dhimbjes...  
Nga kullat e gurta

zgjatej myshku i jetës.  
Një tel çiftelie skuqej në muzgun e kullës.  
Dridhej muzgu,  
dridheshin kullat,  
duke trazuar netëve të gjata honin.  
Po zemrat e nuseve të reja,  
si nuk çaheshin,  
kur burrat ua merrte kurbeti  
në mëngjesin e natës së parë?

Prej dhimbjes  
yjet nga qelli pikoni si lot nusërie  
karmave,  
rrëpirave,  
nëpër hon të natës...

Shumë pranvera iknin  
me zhveshjen e lëkurës së bollave nëpër murrize.  
Marhamat e bardha të nusërisë vjetroheshin  
e mbeteshin ndanë arave me elb e thekër,  
gardhiqeve...

E zemrat e nuseve më të forta se guri,  
zemrat e tyre qëndronin më shumë se burri.

Netëve  
nën çarçafët e nusërisë së vetmuar,  
vajzat e porsamartuara  
mbështillnin dhimbjen e bardhë...  
«O, moj fushë e Korabit,  
o, mjera un-o,  
qysh na ndave shtratit,  
o, mjera un-o!»

Si gur një mijë tonësh  
binte mbi kraharorin e dashurisë  
kjo dhimbje e bardhë...

Nën strehë shkëmbinjsh,  
buzë rrëpirave,  
mbeti i nderë ky tis mjegulle  
«O, mjera un-o!»  
Mafes i lëvyrur në gardh të kohës...  
«O, mjera un-o!»  
Relikë e hidhur në kujtimet e malësore!

## **HAPËSIRAT VEROIRE**

Qiell i paanë  
shkon duke u hapur në kaltërsi.

Fluturim i shqipes  
me sytë në largësi.

Hapësirat veriore  
me gurin e pathyeshëm të besës

gurrë e pashtetur e këngës  
në telat e gjatë të sharkisë.

Hapësirat veriore,  
hapësirë bujare

hapësirat veriore  
etje e pashuar e dashurisë  
në shtegtim kaltërsish...

## **LOTËT E MOTRAVE...**

Lotët e motrave...  
në sytë e brezit tim janë tharë  
dhe kanë lulëzuar nëpër halat e qerpikeve.

Qindra dashuri...

«M'asht zbardhë bjeshka, djalë, me ty,  
m'asht ba zemër e bardha bjeshkë!»

## *AI GJUAN ME BËRRYLA*

Ai është mes nesh.

Shikojeni mirë në sy  
retina shfaq arenën e hakmarrjes së vjetër...

Në cirkovolucionet e trurit të tij  
ndryshk, mjegull...

Ai është mes nesh  
dhe gjuan në ije,  
ashtu në heshtje sa mundet me bërryla.

Ja, desh më goditi edhe mua.  
Vetëm emrin desh ma la,  
edhe zërin desh ma mori.

Dëgjojeni me kujdes, ju lutem,  
nuk është, bre, nuk është artikulimi i tij.

Ai është mes nesh  
dhe i flet kohës me zërin e vjedhur.

Ai është mes nesh  
dhe ta marr zërin.

Ai gjuan keq me bërryla, vëllezër,  
duke mbuluar goditjet me duartrokite dhe

urra...

Ai ka hyrë në radhët tonë  
dhe faron.

Gjuhën tonë ka mësuar  
zërin tonë ka vjedhur.

Ai në heshtje flet me gjuhën e bërrylave,  
shikojeni mirë në sy, vëllezër!

Retina shfaq arenën e hakmarrjes së vjetër...

Ai është i tërbuar kur kujton çifligjet e humbura...  
Edhe në buzë vështrojeni mirë,  
atij i mungon buzëqeshja e vërtetë.

Shikojeni mirë.

Në gojën e tij  
po digjen edhe eshtrat e gjyshit tim të mjerë.

Ai i këndon gjyshit të tij  
duke i veshur lëvozhgë emrin e gjyshit tim.

(Po gjyshi i tij qe bajraktar  
e gjyshi im trim fukara.)

Gjyshit tim iu rexh supi e iu thî syu në thep të  
pushkës,  
gjyshi tij «luftonte» llogoreve me para...)

Ai ecën nëpër lulëzimin e ditëve tona  
dhe ëndërron përtej mesjetës...

Gjuhën tonë ka mësuar,  
zërin tonë ka vjedhur.  
Ai gjuan keq me bërryla.

Ta dërrmojmë, vëllezër  
që mos të farojë në radhët tona!

## NË ÇATINË SHKËMBORE TË BJESHKËVE

Në çatinë shkëmbore të bjeshkëve  
këmbëzbathur më gjeti liria.

Atëherë  
luaja me ditët e fëminisë sime guraleca.

Unë fëmi zemrak qaja shullaneve, karmave,  
si quell dimëror me fytyrë të mrolur...

Edhe të vëtmen, Larën (që e ndiqja pas bishtit  
shullaneve) ujku ma gënjeu dhe ma mori e nuk ma ktheu më...

Unë thërrisja me sytë e përlotur gurëve të Hasit:  
«O Larooo!... Oooo!...»  
Po Lara s'u kthyte më, më ktheu vetëm vetminë  
fëminore karmave...

Në rrasë të diellit këmbëzbathur, duke luajtur  
me erën,  
më gjeti liria.

Atëherë

sytë më mbetën në të  
fëmi — harrova lodrat e fëminisë...

Me vrapin e erës u lëshova në rrugën e saj.  
Pa të, veç pjesë të këtij dheu kur të më gjeni...

**NJË GJETH I ARTË NGA KURORE HERONJSH –  
SHQIPËRIA**

Një gjeth – Shqipëria  
vendosur në globin tokësor.  
Një gjeth i artë nga kurorë heronjsh –  
**SHQIPËRIA!**

Armiq të vendit tim!  
Atdheu im – i madh,  
atdheu im – bujar...  
Për të gjithë ju, këtu ka vend vetëm për varr...  
Një gjeth i artë nga kurorë heronjsh –  
**SHQIPËRIA!**

## RAPSODI E PËRGJAKUR...

Kushtuar qëndresës së popullit të  
krahinës së Lumës kundër shovinistëve  
serbomëdhenj në luftën e vitit 1913.

### PROLOG

Rezet e hënës pikonin gjak  
trup i foshnjës ngrirë bajrak...

#### 1.

Toka — skuqur,  
flakë — qielli,  
hëna — nxirë,  
gjak — dielli.

Brigjet e Drinit gjak kullokan,  
Luma e krajli ç'po luftokan!

#### 2.

Ku shkon krajl —  
bërtitka Luma —

«të mbush shpinën  
plot me plumba».  
Kjo Gjalica veç shkëmb e gurë,  
tyta pushkësh më shumë se drurë.

3.

Gurët-bomba,  
thika-bari,  
piskatë-era  
me zë shqiptari.

Luftojnë djemtë me jatagana  
për këto ditë na i ka rritë nëna!

4.

Në llogore  
fëmijë e gra  
mbi ta yje  
paskan ra...

Klithmë e foshnjës therka qiellin,  
foshnjat-heronj mbrokan djepin!

5.

Dhëmb për dhëmb  
e thikë për thikë,  
gra e burra  
dhe fëmijtë.  
Rrezet e hënës pikokan gjak  
trupi i foshnjës për bajrak!

**6.**

Ikin serbët për nën hënë,  
gjaku sytë u ka zënë...

**7.**

Gurë e pushkë ky vend i shkretë  
le e rritë llogoreve!

### **EPILOG**

Rrezet e hënës pikonin gjak,  
trupi i foshnjës ngrirë bajrak.

Rrezet e hënës teh i thikës,  
çajnë shekujt bijtë e Shqipes!

## O-O-O AZEM BEJTA!

Te një shpellë ulet shqiponja, piskat,  
këtu rron, ai rron...

Ngrihet, përplas krahët, i shtrin si shpatë,  
atje rron, ai rron...

Në e kërkofshi emrin, ky gur e ka,  
atje rron, ai rron...

Zërin erës ia ka dhënë në shulla,  
vajton për të, ajo kushtron...

Nëpër kokrrizat e këtij dheu zemrën ke lënë,  
rreh ajo, ajo kuqlon...

Nëpër mote, guva shpellash gjëmuani,  
diku rron, ai rron...

Kjo tokë emrin ta ruan,  
kahmos rron, ti rron...

Mbi varret e armiqve korba gjithnjë fluturuan,  
këndon ti, ngado këndon...

Shqipëria nënë armët ngjeshur i ka,  
besa jote lulon, në çdo lis e gur  
lulon.

Shqipëria nënë emrin lart ta ngre,  
burri i besës rron, këtu rron...

O-o-o-o Azem Bejta!

## **KADRI ALPAPES**

O Kadri Alpapa,  
o gjaku ynë!

Buzë Drinit të varën nazistët, nën një shelg,  
e Drini i Bardhë u ngrit me shkulme...

O Kadri Alpapa,  
therror i një bese!

Të tjerë nazistë me histerizëm  
nga bregu mbi Drinin shtinë,  
po ai shembi brigjet,  
nazistët i mbyti me gjëmime.

O Kadri Alpapa,  
vëlla me lirinë!

Kur erdhi pranvera,  
shelgu s'çeli më,  
erdh një zog shtegtar  
e qëndroi mbi të.

Që nga ajo ditë  
brigjeve të Drinit këndon:  
«S'ka vdekje më të bukur,  
për lirinë kur lufton!»

## **POPUJT BËJNË LUFTEN...**

Në fushën e betejës  
 popujt mbjellin gjakun,  
 kockat...

Toka u ngop së thithuri  
 gjak  
 dhe predha...

### **Nesër**

e shtrënguar është Toka prapë  
 të çelë hapësira me trëndafila gjaku.

Gjaku çel lulet e veta —  
 në buzët e popujve  
 përditë trëndafila të bardhë lirie!

«Tri botë» e «superfuqi»  
 do të hidhen tutje si kërpudha  
 ndanë brigjeve të kësaj rrjedhjeje gjaklirie!

## TRYEZA E MBRËMJES

Gjëra të thjeshta shtrohen në tryezën tonë të mbrëmjes.

Metamorfoza e djersës që kripoi fushën  
shtrohet mbi tryezë në formën e bukës,  
me ngjyrën e zarzavateve,  
me ngjyrën e mushtit të frutave.

Flasim e qeshim rrëth e përqark tryezës së qetë  
të mbrëmjes  
dhe sytë tanë plot dritë herë pas herë i ngremë.

Në cepin e tavolinës sonë të qetë të mbrëmjes  
shqetësimi na veton  
për Botën Proletare.

Tryeza jonë e mbrëmjes ende s'është e qetë,  
përderisa ende vdesin urie në këtë planet!

## BOTA PLAKË AKOMA KËNDON MESHË

«Santa Maria! Santa Rexhina!...»

Bota plakë ende këndon meshë  
me fraza liturgjike të një gjuhe të vdekur.

Bota e plakur ende vajton meshë,  
nëpër qerpikët e saj kullojnë qirinjtë e djegur...

Bota plakë ende këndon meshë nëpër katedrale,  
bota proletare  
mbi hapësirën e këtij shekulli,  
fuqishëm këndon Internacionalen:

«Nga zot e mbret s'duam shpëtimin  
as nga heronjtë kordhëtarë,  
me duart tona ne qirimin  
do ta fitojmë, o proletarë».

Bota proletare me marksizëm-leninizmin, flakadan  
në duar,  
po ia djeg qirinjtë mesjetarë dhe sytë botës së  
shuar!

## **ERA E SANËS**

Era e sanës —  
vjen nga piramidat prej fijesh bari në shpatin e  
Pushtrikut.

Erë lulesh të egra bjeshke  
e bari përzier  
me rrënjet nëpër të cara shkëmbinjsh.

Era e sanës  
hukamë e bjeshkës buzëmbrëmjeve  
me shallin e dritave hedhur mbi supe.

Era e sanës —

romantikë e fëminisë sime me këmishë bezi  
murrizave lëvyrë...

Era e sanës,  
erë shëndeti...

## *RRITU BIR TË VRAPOJMË ME ERËN*

Rritu bir të vrapojmë me erën,  
o, sa bukur bir,  
të vraposh me erën!

Me erën që derdhet furishëm nga Gryka e Vaneve,  
me erën që vrapon nga Qafa e Zbinecit  
e përplaset me zëra 'gazmorë nëpër fasadat e  
qytetit.

Të qytetit të ri, bir,  
se të vjetrin e shembëm.

Tash ka mbetur si arushë e vrarë me kokë e brinjë  
të thyera,  
pa frymë, mes dy Drinave shtrirë,  
ku dhe ti mund të luash me të, bir.  
Të vjetrin e kemi futur nëpër albume,  
nëpër albume, bir,  
ku ndodhet fotografia jote para çerdhes së vjetër...

Eja bir, të vrapojmë, të harlisemi me erën!  
Me erën, bir,  
shpirtin e trazuar të natyrës,  
që kuis nëpër tela e dritare,

që trokon hapësirave e nëpër majat shamibore  
të maleve,  
me erën, bir,  
të qeshurën e shfrenuar të natyrës,  
që gajaset e lëmohet me gojfilet e mbirë karmave,  
shullaneve,  
shullaneve, bir, e shkëmbinjve të plasaritur, nga  
era çarë e thërrmuar,  
që thërrmohet nëpër parvazet e dritareve të qytetit  
tonë të ri,  
që hyn nëpër dritaret e kuzhinës e të dhomës tonë,  
ku rrimë e tregojmë përralla të bukura për erën.

Rritu, bir, sa më shpejt rritu ti, të vrapojmë së  
bashku me erën!  
E, kjo erë, është e mirë,  
e mirë, bir-o, e ngrohtë,  
që di të çelë vetëm dushkun e njomë dhe lulet  
ngjyrë zjarri,  
lulet, bir, të porsambjellura në parkun e qytetit  
tonë të ri,  
me erën, bir, që di të luajë edhe me ty,  
si me vogëlushët tjerë, duke ua ngritur lart e më  
lart balonat e ngarkuara me èndrra.

E gëzuar është kjo erë e mirë.  
Dhe a e di se ku e ka shtëpinë, bir?  
Në qytetin tonë të ri, afër çerdhes së re,  
afër çerdhes së re me fytyrë nga Liqeni i Dritës,  
me fytyrë nga Dielli,

Ku po rriten qindra luanë të tjerë,  
si ti, biri im,  
dashuria ime e përtërirë, e re,  
si rrjedha e kësaj ere,  
që luam me zërat gazmorë rrugëve të asfaltuara të  
luan me vogëlushët  
që flokët ua trazon dhe u bën shoqëri,  
u bën shoqëri të mirë, bir,  
bën lodra të bukura prej bore,  
më të bukura se lodrat prej porcelani dhe gome.  
Vrapon kjo erë, bir, e nuk lodhet kurrë, vrapon,  
vrapon...  
Më tepër se gjogu jelëbardhë në parkun e lojrale  
dhe merr në shpinë kalistrok  
vëllezërit dhe motrat e tua të çerdhes  
dhe trokon me hingëllimë duke luajtur e gajasur  
me gjithë shpirt,  
vrapon rrugëve,  
vrapon parqeve  
dhe përtej periferisë së qytetit, fshatrave,  
kacavarret nëpër fasada e ballkone,  
zbret pastaj poshtë thik,  
më bukur se ariu i murrmë dhe majmuni Liza në  
kopshtin zoologjik.

Rritu, rritu, bir, të vrapojmë me erën!  
Me erën që fryn e fryn në qytetin tonë,  
me erën, bir, që çel lulet e pemëve,

me erën, bir, fshesarin e mirë të rrugëve,  
me erën, bir, kopshtarin e mirë të mollëve,  
që të krimburat i rrëzon nëpër tokë, i hedh tutje  
përrojeve...  
dhe rrit për ju të kuqluarat, të émblat, majhoshet.

Ti rritu, pra, bir, të vrapojmë e të luajmë me erën!  
Me erën, bir, që këndon me zë të lirë në qytetin  
tonë të ri.  
Ka mbledhur zërat më të bukur të të gjithë  
këngëtarëve dhe këndon,  
këndon, bir,  
këndon shumë bukur kjo erë,  
më bukur se zogjtë dhe papagajtë e gjithë kopshteve  
zoologjikë të botës,  
këndon e nuk lodhet asnjëherë,  
me zërin e lahitës e të sharkisë,  
me zërin e fyellit, të barit dhe gjethit,  
këndon përditë.  
vëllezërit dhe motrat e tua të çerdhes,  
këndon për të gjithë fëmijët,  
edhe për ty, bir, kjo erë,  
kurse babai ka mot që lëshon këngën e lirë të  
bregut të Drinit,  
për këtë erë,  
për erën e qytetit tonë të ri,  
për erën që din të çelë dushkun e njomë dhe lulet  
e mollëve,  
që di të çelë çdo ditë portat e qytetit tonë,  
dritaret tona.


Nga kjo erë, do të mësosh, bir,  
si në përrallat dhe legjendat,  
se shumë sy u mbushën me rërën e Drinit të Zi,  
shumë ëndrra u shndërruan në gur  
e të tjera ëndrra çanë edhe shtratin e lumi  
e brigjeve bleruan në shelgje  
e brigjeve luluan në lule bozhurë.

Drini i Zi, bir,  
shumë njerëz na ka vjedhur me vdekjen  
sytë e nënave i ngriu kah brigjet  
shumë motra pritën kthimin e vëllezërve,  
të vëllezërve, bir, Gjergj Elez Ali,  
që mundeshin brigjeve me balozat e tokës  
e tokës mbillnin këngën:  
                  «jani krisi pushka,  
                  jani bregut të Drinit...»  
e brigjet rriddhnin gjak...

Eja, bir, të vrapijmë me erën,  
me erën, bir, sa mushkëritë të na shkyhen  
e gjymtyrët të na lodhen  
nga mëngjesi gjer në mbrëmje vonë,  
me këtë erë, bir,  
me flokët e vesuara nga yjet,  
me këtë erë

që flet me zërin tënd dhe timin,  
me erën që flet me zërin tonë,  
që është kallur nga dashuria jonë!

Eja, bir, eja të vrapijmë e të vrapijmë gjer në  
fund me këtë erë!



## PASQYRA E LËNDËS

Ura e madhe .....	3
Rrjedh një lumë .....	5
Një kujtim fëminie .....	6
Likeni i kuq .....	7
Nuk donim të qanim .....	9
Vlorë .....	11
Unë dhe Drini .....	12
Malet shqiptare .....	13
Në fushën e stërvitjes .....	15
Duke parë kostarët .....	16
Pikllime .....	18
Sa herë .....	20
Kur hyj në qytetin e dëshmorëve .....	21
Tokat e mbjellura .....	22
Gjërsi .....	23
Në këmbët e urave .....	24
Qyteti i ri .....	25
Nuk harrojmë .....	27
Djepi .....	29
Duke kërkuar këngën për popullin .....	31
Hoj, dado, hoj! .....	32
Nga ku nisin udhën ditët... .....	34
Kur prek populli telat e sharkisë .....	36